**VENDIM**
**Nr.249 datë 5.6.1992**

**PËR KRIJIMIN E INSTITUTIT TË SIGURIMEVE SHOQËRORE**

Në mbështetje të neni 4 të ligjit për sigurimet shoqërore shtetërore", me propozimin e Ministrisë së Financave dhe të Ekonomisë, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Krijimin e Institutit të Sigurimeve Shoqërore në vartësi të Këshillit të Ministrave, si institucion shtetëror i ngarkuar për administrimin e sigurimeve shoqërore.

2. Instituti i Sigurimeve Shoqërore, në kryerjen e funksioneve të tij, mbështetet në ligjin "Për Sgurimet Shoqëror e Shtetërore" dhe në aktet e tjera ligjore e nënligjore që rregullojnë marrëdhëniet në fushën e sigurimeve shoqërore.

3. Instituti i Sigurimeve Shoqërore ka këto detyra e të drejta

- Drejton, organizon dhe kotrollon për zbatimin unik e të njesuar të ligjshmërisë në fushën e marrëdhënieve të sigurimeve shoqërore për punëtorët, nëpunësit dhe subjektet private, pavarësisht nga format e organizimit të tyre.
- Mbron intersat dhe të drejtat e punonjësve e të pensionistëve në fushën e sigurimeve shoqërore.
- Kryen studime të rëndësishme shkencore në fushën e sigurimeve shoqërore dhe punon për përmiresimin dhe përsosjen e vazhdueshme të legjislacionit në përputhje me mundësite ekonomike.
- Nxjerr akte nënligjore për organet e tij vartëse, në mbështetje të akteve ligjore dhe kompetencave të dhëna për zbatimin sa më drejt të ligjshmërisë në këtë fushë.
- Drejton, ndihmon dhe kontrollon organet e saj vartëse në rrethe për përsosjen e organizimit e të drejtimit të punës, zbatimin e ligjshmërisë e të kompetencave në këtë fushë dhe forcimin e kontrollit dhe rritjen e efektivitetit.

4. Instituti i sigurimeve Shoqërore është person juridik me qendër në Tiranë, i cili drejtohet dhe përfaqësohet nga drejtori.

5. Instituti i Sigurimeve Shoqërore ushtron veprimtarinë e tij ekonomike dhe financiare në mënyrë të pavarur. Me të ardhurat që realizohen nga kontributi që derdhin subjektet e siguruara dhe financimi buxhetor, përballon shpenzimet që përfitojnë punonjësit nga ligji i sigurimeve shoqërore. Teprica e fondeve që rezultojnë në fund të çdo periudhe, nuk derdhet në buxhetin e shtetit, por ,mbahet për periudhën pasardhëse.

6. Instituti i Sigurimeve Shoqërore ka këto organe:

a) Drejtorin

b) Këshillin adminsuirtrativ.

Kompetencat e këtyre organeve përcaktohen në statutin e institutit dhe rregulloren e brendshme të tij, që miratohen nga kryesia e Këshillit të Ministrave.

7. Instituti i Sigurimeve Shoqërore ka aparatin e tij dhe organet vartëse në rrethe, të cilat varen dhe kontrollohen nga ky institucion.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI I KËSHILLIT TË MINISTRAVE
**Aleksandër Meksi**